

VLERËSIMI I KËNAQËSISË SË STUDENTËVE TË MASTERAVE TË MËSUESISË AML, NË FSHN, UT

ALEKO MIHO.¹, SHEQERE BALOSHI.²

¹Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë

²Sopot, Dibër

Përmbledhje

Testi i kënaqësisë (*SSI, Student Satisfaction Inventory*) është një mjet i fuqishëm për institucionet e arsimit të lartë sot në botë për njohjen dhe përsosjen më tej të cilësisë së jetës universitare dhe të mësimdhënies, duke mbajtur lart normat e tërheqjes së studentëve. Në këtë punim jepen dhe diskutohet për herë të parë interesi i studentëve dhe kënaqësia e përbushjes nga fakulteti ynë nëpërmjet së një kampioni prej 132 studentësh të masterit të Mësuesisë AML, Biologji & Kimi (2014-2015), FShN, UT; këta u janë përgjigjur 22 pyetjeve duke përdorur një sistem me 5 shkallë, nga 'Nuk ka aspak rëndësi' deri 'Ka shumë rëndësi' për dëshirat, dhe 'Aspak i/e kënaqur' deri 'Shumë i/e kënaqur' për kënaqësinë e përbushjes (shkalla Likert). Për çështjet: 'fusha e studimit', 'brendia e saj', 'plani mësimor', 'cilësia e mësimdhënies', tipi e diplomës' dhe 'profesioni i mësuesit', duket se ka përputhje të plotë mes rëndësisë dhe shkallës së lartë të kënaqësisë; këto mund të konsiderohen edhe si anë të forta të fakultetit, me shumë traditë në mësimdhënie. Por në tërësinë e vet, si dhe për shumë aspekte të veçanta, nuk duket se shfaqet përputhje e mirë mes dëshirave dhe kënaqësisë studentore relativisht mesatare apo të ulët. Kënaqësia është 'çka' ose 'i/e pakënaqur' për 'kushtet laboratorike', për 'kompiuterat dhe internetin', dhe për 'praktikat'; pak a shumë po kjo është edhe për 'librat', për 'vlerësimin'; studentët nuk duken të kënaqur edhe nga 'kushtet e mësimdhënies' dhe 'shërbimet' që lidhen me të. Dëshirat e studentëve janë shumë të mëdha për 'shkëmbime me jashtë shtetit' dhe për të patur një rrjet shkëmbimesh me vendet e zhvilluara europiane.

Fjalëkyçet: Masteri i Mësuesisë AML; Testi i kënaqësisë (SSI); FShN, UT.

Abstract

Student Satisfaction Inventory (SSI) gives a powerful tool to improve the quality of student life and learning. In this paper, it is given and discussed for the first time the data obtained by a student satisfaction test organized with a representative group of 132 students of the Master of Education AML, Biology & Chemistry (2014-2015), FNS, UT; it was made possible through a test of 22 questions, where importance and satisfaction was compared using a five scale scoring (Likert scale). On issues, such as 'the scope and content of the study', 'the curriculum', 'the quality of teaching', 'the quality of diploma' and 'teaching as a profession', it seems to be a full compliance between importance and high satisfaction level; it can be considered as good strength of our faculty, known for its tradition in teaching. But in its whole view, and in several specific issues, it does not seem to appear good match between the importance and relatively moderate or low student satisfaction. Satisfaction score belong to 'Neutral' or even 'Not satisfied' for 'laboratory conditions', 'computers and internet', and 'practices'; more or less the same was expressed for 'books', for 'evaluation'; students do not seem satisfied with the 'conditions of teaching' and 'services' associated with it. Strong desires were expressed towards 'exchanges with abroad' and related to a cooperation network with developed European countries.

Keywords: Master of Education AML; Student satisfaction test (SSI); FNS, UT.

Hyrje

Arsimi, veçanërisht arsimi i lartë, është faktor drejtues kyç për rritjen ekonomike. Ndërkohë, tregu i arsimit të lartë po bëhet gjithnjë e më konkurrues, dhe përmbushja e dëshirave (kënaqësia) e studentëve është një tregues cilësor i rëndësishëm. Thomas & Galambos (2004) dhe të tjerë studjues pohojnë deri edhe aty sa studentët mund të quhen si konsumatorë të shkollës së lartë. Një studim i Wiers-Jenssen *et al.* (2002) ka provuar se faktor përcaktues në kënaqësinë e studentëve është cilësia e mësimdhënies, si nga ana akademike dhe pedagogjike. Për këtë, përmbushja e dëshirave të studentëve në universitet ka rëndësi për suksesin e institucionit. Ata institucione që janë efektive kanë studentë të kënaqur dhe kjo ndihmon që të pasohen edhe nga të tjerë në të ardhmen. Për këtë renditja e kënaqësisë së studentëve po bëhet gjithmonë dhe më transparente dhe nxirret shpesh në dukje. Për rrjedhojë shumë universitete sot në botë kërkojnë vazhdimisht si të përmirësojnë nivelin e kënaqësisë së studentëve në institucionin e tyre (https://en.wikiiversity.org/wiki/University_student_satisfaction).

Testi i kënaqësisë (*The Student Satisfaction Inventory, SSI*) është një mënyrë për të vlerësuar kënaqësinë e studentëve në një institucion të arsimit të lartë. SSI mat cilat janë përparsitë e dëshirave studentore dhe cila është shkalla e përmbushjes, pra sa janë të kënaqur studentët, dhe cilat çështje janë më të rëndësishme për ta. Testi i kënaqësisë është i dobishëm për të orientuar planet strategjike të zhvillimit të një institucioni arsimor, për të fuqizuar nismat për tërheqjen dhe mbajtjen e studentëve, për të përmbushur kërkesat për akreditim, për të njohur cilat janë anët më të forta të institucionit me qëllim reklame, si dhe për të përcaktuar cilat kanë qënë arritjet brenda kampusit universitar. Për shëmbull, autoritetet e arsimit të lartë në ShBA takohen çdo vit me kompaninë Ruffalo Noel Levitz (2016), e njohur në fushën e informacionit, dhe me përvojë në organizimin e SSI; janë rreth 4,900,000 studentë nga në 2,600 institucione në gjithë Amerikën e Veriut me të cilët kjo kompani ka bashkëpunuar që prej vitit 1937 për këtë.

Vlerësimi i shkallës së kënaqësisë së studentëve dhe përvoja e organizimit të testit të kënaqësisë në institucionet shqiptare të arsimit të lartë është thujase e panjohur. Nxitje për këtë u bë një punim i ngjashëm diplome nga M. Skrelja (2016), e cila qershorin e kaluar (2015) ishte në Shqipëri duke bërë një anketim të ngjashëm me studentët e degëve të biologjisë (Bachelor dhe Master Mjedisi) në Universitetin e Tiranës, atë të Vlorës dhe të Zyrhut, mbështetur në përvojën amerikane të Ruffalo Noel Levitz (2016). Një test të ngjashëm përshtatëm më tej për studentët e masterit të mësuesisë AML Biologji/Kimi (2014-15), rezultatet dhe diskutimet e të cilit përbëjnë thelbin e këtij punimi. Ne mendojmë se kjo përvojë fillestare mund të shërbejë jo vetëm për Universitetin e Tiranës, por për gjithë institucionet e arsimit të lartë (IAL) në gjithë për vendin, për njohjen dhe përsosjen më tej të cilësisë



së jetës studentore dhe të mësimdhënies, duke mbajtur lart shkallën e tërheqjes së studentëve prej secilit institucion.

Materiali dhe metodat

Pyetësi për këtë punim është hartuar sipas testit të mikrotezës së Skrelja (2016), të zhvilluar po me studentët tanë të Biologjisë në Tiranë, Vlorë dhe Zyrë. Ky test ishte ndërtuar nga ana e saj në përputhje me kërkesat e testit të kënaqësisë (SSI) të Noel-Levitz (2016). Pyetësi i Skrelja (2016) kishte pyetje të përgjithshme për studimet biologjike, lidhur më shumë me çështje të biologjisë mjedisore (Tab. 3). Një pjesë e pyetjeve të këtij testi (Tab. 2), janë të ngjashme me atë pyetësor, por ky test është zgjeruar dhe përshtatur për kursin tonë të mësuesisë AML, si objekt i mikrotezës së Baloshit (2016).

Pyetësi i ynë i kënaqësisë, i titulluar ‘*Vetëm 5 minuta reflektim për Institucionin tuaj*’, u ndërtua me 22 pyetje, të cilat jepen në tabelën 2. Çështjet që prekin pyetjet ishin: fusha e studimit dhe brendia e saj; planet mësimore; cilësia e mësimdhënies; pajisjet dhe ushtrimet laboratorike; mundësitë kërkimore; praktikat në terren dhe ato pedagogjike; librat; vlerësimi; shërbimet këshillimore; prania e punonjësve; kushtet e mësimdhënies; shërbimet për studim, për argëtim dhe çlodhje; diploma master; profesioni i mësuesisë; shkëmbimet me jashtë dhe rrjeti i mësimit-kërkimor i bashkëpunimit me universitetet e BE-së. Si rregull gjatë SSI maten dy aspekte: **rëndësia** dhe **pëlqimi**, duke përdorur një sistem me 5 shkallë Likert (1932), si në tabelën 1.

Tabela 1. Sistemi i vlerësimit me 5 shkallë Likert (1932) për secilën pyetje të testit të kënaqësisë.

Rëndësia për mua			Kënaqësia e përmbushjes		
 Ulët ↓ Lartë	Nuk ka aspak rëndësi	1	Aspak i/e kënaqur	1	 Ulët ↓ Lartë
	Jo me shumë rëndësi	2	Jo i/e kënaqur	2	
	As po as jo	3	Çka	3	
	Ka rëndësi	4	I/E kënaqur	4	
	Ka shumë rëndësi	5	Shumë i/e kënaqur	5	

Për lehtësi interpretimi dhe paraqitje sa më qartë të ndryshimeve përveç vlerësimit me pikë (1-5), kemi përdorur dhe ngjyrimin, duke u inspiruar nga vlerësimi me ngjyra i cilësisë së ujërave në Direktivën Europiane të Rrjetit të Ujërave (WFD, 2000), ku ngjyra blu, është cilësia shumë e mirë; jeshile, e mirë; e verdhë, mesatare; portokalli, e varfër; e kuqe, e keqe.

Gjithsej në këtë anketim (Baloshi, 2016) morën pjesë 132 studentë, nga tre kurset e masterit shkencor të mësuesisë AML (2014-15), përkatësisht të vitit të parë Biologji (44 studentë), të vitit të dytë Biologji (59 studentë) dhe të vitit të parë Kimi (29 studentë). Përgjigjet jepen në tabelën 2 për secilën pyetje. Skrelja (2016) testoi 158 studentë nga dega jonë e Biologjisë (132 studentë në bachelor; 22 studentë të masterit shkencor të Biologjisë së Mjedisit; 4 studentë të doktoratës së Biologjisë së Ruajtjes). Këto të dhëna

janë përmbledhur së bashku me të dhënat tona për qëllime krahasuese në tabelën 3.

Rezultatet

Në tabelën 2 jepet mesatarja e vlerësimit të anketimit për secilën pyetje dhe shkalla përkatëse e përmbushjes, si për dëshirën dhe për kënaqësinë, sipas klasifikimit të tabelës 1. Në mikrotezën e Baloshit (2016) gjenden të dhënat e plota të testimit.

Tabela 2: Mesatarja e vlerësimit të anketimit dhe devijimi standard për secilën pyetje, dhe ngjyrimi sipas pikëve të tabelës 1.

Rëndësia	Mesatarja	DS	Kënaqësia	Mesatarja	DS
1. Shkalla e njohjes së <u>fushës së studimit të Biologjisë/Kimisë:</u>					
Shumë rëndësi	4.72	0.51	I/E kënaqur	3.77	0.71
2. Sa e gjykoni të dobishme <u>brendinë e fushës së studimit në Biologji/Kimi:</u>					
Shumë rëndësi	4.61	0.60	I/E kënaqur	3.67	0.92
3. Si mendoni mbi <u>përbërjen e lëndëve të Planeve Mësimore që Ju kini ndjekur:</u>					
Ka rëndësi	4.25	0.72	I/E kënaqur	3.60	0.86
4. Si është <u>cilësia e mësimdhënies</u> që të përfitohet sa më shumë nga ana mësimore-shkencore:					
Shumë rëndësi	4.61	0.73	I/E kënaqur	3.50	1.04
5. Sa të përshtatshme dhe mjaftueshme janë <u>pajisjet laboratorike:</u>					
Shumë rëndësi	4.64	0.74	Çka	3.20	1.11
6. Sa të përshtatshme dhe mjaftueshme janë <u>praktikat në terren:</u>					
Shumë rëndësi	4.56	0.79	Çka	3.20	1.37
7. <u>Laboratorët me kompjuterë dhe internet</u> sa janë të përshtatshëm dhe në përdorim:					
Ka rëndësi	4.28	0.85	Jo i/e kënaqur	2.40	1.38
8. Sa të përshtatshëm dhe mjaftueshëm janë <u>librat në përdorim:</u>					
Shumë rëndësi	4.55	0.68	Çka	3.46	1.01
9. Si i gjykoni <u>vlerësimet me notë gjatë cikleve të studimeve:</u>					
Shumë rëndësi	4.54	0.76	Çka	2.74	1.14
10. Sa janë të dobishme dhe gatshme në kohë <u>shërbimet këshillimore</u> për studentin:					
Ka rëndësi	4.41	0.81	Jo i/e kënaqur	2.30	1.10
11. Sa janë të <u>pranishëm punonjësit</u> në Fakultet gjatë apo pas orarit të mësimi (punës):					
Ka rëndësi	4.16	1.05	Çka	3.05	1.16
12. Sa janë të përshtatshme dhe mjaftueshme <u>kushtet e mësimdhënies:</u>					
Shumë rëndësi	4.73	0.59	Çka	3.37	1.01
13. Sa janë të përshtatshme dhe mjaftueshme <u>shërbimet për studim të pavarur:</u>					
Ka rëndësi	4.33	0.85	Çka	2.65	1.21
14. Sa janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme <u>shërbimet për argëtim dhe lodhje:</u>					

Rëndësia	Mesatarja	DS	Kënaqësia	Mesatarja	DS
Ka rëndësi	4.13	1.01	Jo i/e kënaqur	2.05	1.20
15. Sa është për Ju tërheqëse një diplomë Master në Mësuesinë e Biologjisë/Kimisë për AML:					
Shumë rëndësi	4.74	0.56	I/E kënaqur	3.90	1.07
16. Sa rëndësi ka për Ju Mësuesia e Biologjisë/Kimisë për AML në studimet universitare:					
Shumë rëndësi	4.82	0.42	I/E kënaqur	3.90	1.00
17. Sa përmbushet në UT çështja Mësuesi e Biologjisë/Kimisë për AML:					
Shumë rëndësi	4.61	0.64	I/E kënaqur	3.62	0.96
18. Sa jepet mundësia për të kryer ushtrime të ndryshme në laborator në Programin e Studimit të Masterit Shkencor Mësues i Biologjisë për AML:					
Shumë rëndësi	4.50	0.74	Çka	2.76	1.18
19. Sa janë të përshtatshme dhe mjaftueshme Praktikat pedagogjike të Masterit të Mësuesisë së Biologjisë:					
Shumë rëndësi	4.77	0.54	Çka	3.45	1.19
20. Larmia e mundësive kërkimore për fushën studimore të Mësuesisë së Biologjisë/Kimisë:					
Ka rëndësi	4.48	0.75	Jo i/e kënaqur	2.45	1.19
21. A do të ishte i dobishëm shkëmbimi i studentëve midis Shqipërisë dhe vendeve të BE-së për të mësuar më shumë për Mësuesinë e Biologjisë/Kimisë:					
Shumë rëndësi	4.66	0.69	Jo i/e kënaqur	2.10	1.40
22. Një rrjet mësimor-kërkimor midis universiteteve të Evropës Lindore dhe Perëndimore është / do të ishte i dobishëm për studentët e Biologjisë/Kimisë:					
Shumë rëndësi	4.56	0.73	Jo i/e kënaqur	2.16	1.42
Gjithsej anketimi:					
Ka rëndësi	4.42	0.74	Çka	3.06	1.12

Anketimi ynë, sado i thjeshtë në mënyrën e organizimit, mendojmë se përfaqëson relativisht mirë mësimdhënien në masterat tanë të mësuesisë, ndoshta dhe më shumë për shkollën tonë të lartë publike. Kjo sepse janë gjithsej 2904 vota në gjithë anketimin (22 pyetje x 132 studentë), përkatësisht për rëndësinë dhe pëlqimin e përmbushjes së një çështje (Fig. 1); por edhe pse shumë pyetje kanë vështrim më të gjerë në mësimdhënie dhe në kushtet e jetës studentore (Tab. 2).

Konkretisht për tre pyetjet e para (**fusha e studimit, brendia e saj dhe plani mësimor**) duket se ka përputhje të plotë mes rëndësisë dhe kënaqësisë së përmbushjes; kënaqësia duket e mirë ose shumë e mirë për të tre këto pyetje, si në përgjithësi, ashtu dhe nga të tre grupet përbërëse në anketim (Tab. 2). Po kjo sjellje duket edhe në pyetjen e katërt mbi **cilësinë e mësimdhënies**; me përjashtim të kënaqësisë 'Çka' të grupit AML Biologji viti i parë, si vlerësimi i përgjithshëm dhe dy grupet e tjera ishin të kënaqur lidhur me cilësinë e mësimdhënies. Ashtu si dhe me pyetjet e para, vihet re shkallë e mirë përputhje mes dëshirave dhe kënaqësisë së mirë lidhur me **cilësinë e**

diplomës apo me **profesionin e mësuesit** të zgjedhur prej tyre, dhe shkallën e përmbushjes së tyre prej fakultetit tonë.

Shkalla e kënaqësisë së gjithë studentëve ndryshon dukshëm në pyetjen e pestë, të gjashtë dhe shtatë; përgjigja e kënaqësisë është 'çka' ose 'i/e pakënaqur' për **kushtet laboratorike**, për **kompiuterat dhe internetin**, dhe për **praktikat mësimore apo në terren**; pak a shumë kjo sjellje kënaqësie është edhe për **librat**, dhe për **vlerësimin me notë**. Studentët nuk duken gjithashtu të kënaqur edhe nga **kushtet e mësimdhënies**, **shërbimet për studim të pavarur**, **shërbimet për argëtim e çlodhje**, **shërbimet këshillimore në fakultet**, apo dhe nga **prania e punonjësve në shërbim** të tyre (Tab. 2; Fig. 3).

Tabela 3: Të dhëna e përftuara nga Skrelja (2016), përputhur edhe me të dhënat tona për dëshirat (D) dhe kënaqësitë (K), për disa nga pyetjet e përbashkëta të dy pyetësorëve. Ngjyrat janë po ato sipas tabelës 1.

Pyetjet		Skrelja (2016)			Baloshi (2016)
		Uni Zyrih (n=174)	Uni Vlorë (n=132)	Uni Tiranë (n=158)	Uni Tiranë (n=132)
		Mes / DS	Mes / DS	Mes / DS	Mes / DS
1. Fusha e studimit: Dëshirat / Kënaqësitë	D	4.65 ± 0.50	4.67 ± 0.47	4.60 ± 0.62	4.72 ± 0.51
	K	4.01 ± 0.58	3.82 ± 0.93	3.29 ± 0.85	3.77 ± 0.71
2. Larmia e lëndëve: Dëshirat / Kënaqësitë	D	4.43 ± 0.60	4.46 ± 0.65	4.35 ± 0.76	4.25 ± 0.72
	K	3.91 ± 0.71	3.89 ± 0.83	3.40 ± 0.93	3.60 ± 0.86
3. Pajisjet laboratorike: Dëshirat / Kënaqësitë	D	3.94 ± 0.76	4.76 ± 0.49	4.72 ± 0.59	4.64 ± 0.74
	K	3.68 ± 0.84	3.31 ± 1.11	2.93 ± 1.07	3.20 ± 1.11
4. Laboratorët me kompiuter: Dëshirat / Kënaqësitë	D	2.88 ± 1.01	4.41 ± 0.75	4.24 ± 0.95	4.28 ± 0.85
	K	3.28 ± 0.77	2.78 ± 1.13	2.43 ± 1.11	2.40 ± 1.38
5. Shërbimet këshillimore: Dëshirat / Kënaqësitë	D	4.04 ± 0.82	4.44 ± 0.61	4.33 ± 0.77	4.41 ± 0.81
	K	3.41 ± 0.90	3.64 ± 1.09	2.57 ± 1.07	2.30 ± 1.10
6. Ushtrime në laborator: Dëshirat / Kënaqësitë	D	3.64 ± 0.92	4.61 ± 0.56	4.50 ± 0.65	4.28 ± 0.85
	K	3.27 ± 0.66	3.75 ± 0.96	3.11 ± 1.03	2.76 ± 1.18
7. Shërbimet në fakultet: Dëshirat / Kënaqësitë	D	3.95 ± 0.84	4.46 ± 0.65	4.28 ± 0.73	4.16 ± 1.05
	K	3.91 ± 0.79	4.07 ± 0.90	3.25 ± 1.09	3.05 ± 1.16
8. Mundësi kërkimi: Dëshirat / Kënaqësitë	D	4.50 ± 0.62	4.52 ± 0.60	4.68 ± 0.56	4.48 ± 0.74
	K	3.86 ± 0.73	3.61 ± 1.04	2.64 ± 1.07	2.76 ± 1.18
9. Bashkëpunimi me Universitete jashtë vëndit - Dëshirat	D	3.24 ± 1.04	4.66 ± 0.52	4.66 ± 0.57	4.56 ± 0.73

Së fundi, dëshirat e studentëve tanë janë shumë të mëdha për **shkëmbime me jashtë shtetit** dhe për të patur një **rrjet shkëmbimesh me vendet e zhvilluara europiane** (Tab. 2); madje si duket dhe nga vlerësimet e Skrelja (2016) në mikrotezën e saj (Tab. 3), dëshirat e studentëve në Tiranë dhe në Vlorë janë edhe më të mëdha për këto çështje, se ato të studentëve në Zyrih.

Në të kundërt me këtë, ndryshimet mes rëndësisë së këtyre dëshirave në Shqipëri dhe kënaqësisë së përmbushjes janë të dukshme, ndoshta ndryshimi më i thellë në gjithë anketimin tonë.

Ndërkohë gjetjet e Skrelja (2016) ishin: vlera të ulëta kënaqësie nga studentët e biologjisë së Universitetit të Tiranës, krahasuar me ata të Universitetit të Zyrihut dhe të Universitetit të Vlorës; në përgjithësi, studentët e Vlorës shfaqën vlera kënaqësie relativisht të larta, të përafërta me ata të Zyrihut (Tab. 3). Vihet re se të dhënat e dy kolonave të fundit në tabelën 3 kanë ngjashmëri të besueshme mes tyre (testi i studentit, $p > 0.05$), që tregojnë se shkalla e kënaqësisë studentore në fakultetin tonë është e përafërt, pavarësisht nga kampionet e ndryshme studentore.

Diskutime

Dy qasje që ndihmojnë në përcaktimin e performancës së një kurrikule janë: **vlerësimi i drejtpërdrejtë** dhe **vlerësimi i tërthortë**. Vlerësimi i drejtpërdrejtë i performancës mund të bëhet nëpërmjet një **provimi standard**; ndërsa një vlerësim i tërthortë mund të bëhet nëpërmjet mendimeve të marra përmes një **anketimi**, p.sh. SSI, ashtu si dhe ky punim. Si theksuam më sipër, konkurenca, tërheqja e studentëve, normat e suksesit, vlerësimi i kurrikulave efektive etj., për shumë universitete sot në botë janë gjithmonë të lidhura me kënaqësinë e studentëve.

Mendojmë se kjo frymë konkurrence dhe vlerësimi i tërthortë i performancës së kurrikulave apo dhe vetë institucioneve tona ka kohë që ka ardhur. Në Shqipëri janë sot 15 IAL publike aktive, në 6 prej të cilave ka diploma mësuesie të ngjashme; nga ana tjetër, është gjithnjë në fuqizim edhe sistemi i IAL-ve private, me 24 institucione (<http://www.aaal.edu.al/>), me prirje në rritje dhe zgjerim të vazhdueshëm; ky lloj sistemi i dyzuar fort, ndryshe nga gjithë vendet në rajon, ka prirje të diversifikohet edhe më tepër me Ligjin e ri të AL (Nr. 80/2015). Ndërkohë, shumë të rinj të talentuar zgjedhin sot të shkojnë për studime jashtë shtetit.

Për këtë, edhe pse i thjeshtë në formën e tij, testi ynë i kënaqësisë ka vlera domethënëse si për pyetjet e veçanta dhe për mesataren e përgjithshme të tyre. I parë në tërësinë e vet, në këtë test kënaqësie nuk duket se shfaqet përputhje e mirë mes dëshirave dhe kënaqësisë së përmbushjes; nga rreth 2900 vota gjithsej për të gjitha pyetjet, rreth 60% e tyre janë në shkallën nga ‘çka’ deri në ‘aspak i kënaqur’ (Tab. 2; Fig. 1).




Figura 1: Shpërndarja e gjithë votave të anketimit sipas grupeve të rëndësisë (1-5, *majtas*) dhe kënaqësisë (1-5, *djathats*) për të gjithë të anketuarit për pyetësin tonë me studentët e Masterit të Mësuesisë AML, Biologji & Kimi (2014-2016). Bëhet fjalë për shpërndarjen e 2904 votave (22 petje x 132 studentë votues) në secilën prej dy serive të votimit. Ngrimi është në përputhje me atë të tabelës 1.

Kjo nuk është e papritur po qe se shqyrtojmë kushtet e rënda në të cilat kalon arsimit ynë në këtë periudhë të gjatë tranzicioni prej mbi 25 vjeçare. Nga Raporti i Monitorimit për 12 mujorin Janar-Dhjetor 2015 nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS) vihet re se nga Buxheti i Shtetit janë dhënë përkatësisht 2.7% e GDP-së për zhvillimin e arsimit në përgjithësi, dhe vetëm 0.4%, për IAL-të (<http://www.arsimi.gov.al/>); këto janë nga më të ulëtat në rajon (Gjonça, 2014), dhe natyrisht këtë e ndjejnë institucionet publike të arsimit të lartë. Në të vërtetë, fakulteti ynë punon me jo më shumë se 60,000 lekë (rreth 420 Euro) për student për vitin 2015, e cila pjesërisht mbulohet nga buxheti i shtetit dhe pjesërisht nga tarifat e shkollimit. Kjo shifër është e përafërt me atë që punon gjithë sistemi ynë publik, por shumë herë më e ulët se sistemi ynë privat, dhe se të ardhurat e institucioneve të tjera të ngjashme në rajon (Gjonça, 2014).

Për më tepër, pas viteve 1990-të kuotat e studentëve në fakultetin tonë janë shtuar, falë kjo e rritjes së kërkesës për diplomat tona, si rrjedhojë edhe e traditës së mirë të trashëguar nga fakulteti. Këtë e tregon dhe përputhja e mirë për këto çështje edhe në testin tonë të kënaqësisë. Natyrisht, shtimi i kuotave të pranimit ka plotësuar edhe nevojën e brendshme për të rritur të ardhurat. Në këtë mënyrë, fakulteti sot ka mbi 7000 studentë, shifër që është shumfish i para viteve 1990-të. Ndërkohë hapësirat për mësimin janë shtuar shumë më pak, krahasuar me shtimin e studentëve, shtimin e diplomave, me shtimin e cikleve dhe të kohëqëndrimit në auditor. Shumë më pak janë shtuar edhe të ardhurat që ka caktuar buxheti i shtetit në këto vite, aspak në përputhje me shtimin e numrit të studentëve.

Kjo duhet të përbëjë shqetësim lidhur me përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe gjithë shërbimeve që lidhen me to në ndihmë të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Për këtë, fuqizimi i lidhjeve të Universitetit me Institucionet e ngjashme në Europë dhe më gjerë, kjo në mënyrë realisht

funkionale, do të zbuste ndoshta më shumë këtë mospërputhje që vihet re, qoftë në çështje të veçanta, qoftë dhe në tërësinë e vet të pyetësorit. Pavarësisht nga këto duhet theksuar se mbeten anë të forta të shkollës sonë çështje të tilla si: fusha e studimit dhe brendia e saj, cilësia e planeve mësimore përkatëse, cilësia e mësimdhënies, profesioni i zgjedhur i mësuesisë dhe pëmbushja e këtij profesioni pranë institucionit tonë. Për të gjitha këto çështje ka përputhje mes dëshirave dhe shkallë relativisht të lartë të kënaqësisë së pëmbushjes.

Falënderime

MSc. M. Skrelja, me origjinë shqiptaro-malazeze dhe banim në Amerikë, ndërkohë ish studente e Masterit të Edukimit në Shkencat Mjedisore, pranë Institutit të Biologjisë Evolutive dhe Studimeve Mjedisore, Universiteti i Zyrihut, Zvicër, ishte e para që na njohu me SSI, na ofroi të dhënat e saj, dhe nxitë për organizimin e testit të kënaqësisë në degën tonë të Biologjisë.

Gjithsej, në këtë anketim morën pjesë 132 studentë, nga tre kurset e masterit shkencor të mësuesisë AML (Biologji & Kimi, 2014-15), dhe 158 studentë nga kurset biologjike (2014-15). Pa bashkëpunimin e Tyre ky punim nuk do të ishte bërë i mundur.

Dr. E. Ibrahim, DB, FNS, UT, nuk përtoi të na ndihmonte për të gjykuar më mirë për interpretimin e të dhënave tona numerike, si dhe për ndërtimin e grafikëve të veçantë që e ilustruan më mirë punën e mikrotezës së Baloshit (2016).

Literatura

Baloshi Sh. (2016): Vlerësimi i shkallës së kënaqësisë së studentëve të Masterave AML të Biologjisë dhe Kimisë, Universiteti i Tiranës. Mikrotezë, FShN, UT: 1-54

Gjonça A. (2014): Raporti përfundimtar për reformimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Tiranë. 1-78. http://www.akti.gov.al/dokumenta/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf

<http://www.aal.edu.al/>

http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/arsimilarte/ligjet/Ligj_80_2015_22_07_2015.pdf

[http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/buxheti/2016/perditesime/Raporti_i_Monitorimit_12-mujori_Janar-Dhjetor_2015_30.01._2016_F_N_\(4\).pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/buxheti/2016/perditesime/Raporti_i_Monitorimit_12-mujori_Janar-Dhjetor_2015_30.01._2016_F_N_(4).pdf)

<http://www.biology.ed.ac.uk/research/groups/jdeacon/statistics/table6.html#Correlation%20coefficient>

https://en.wikiversity.org/wiki/University_student_satisfaction

Likert R. (1932): A technique for the measurement of attitudes. Archives of Psychology 140: 1-55.

Ruffalo Noel Levitz (2016): Student Retention Services from Ruffalo Noel Levitz. Increase college completion rates and strengthen the quality of student life and learning. Ruffalo Noel-Levitz, LLC. 1-16.

https://www.ruffalonl.com/upload/Student_Retention/RetentionServices.pdf

Skrelja M. (2016): The status quo of biology curricula: Comparing student satisfaction at Albanian and Swiss universities. Diploma theses. Institute of Evolutionary Biology and Environmental Sciences. University of Zurich. 1-47

Thomas E., Galambos N. (2004): What Satisfies Students? Mining Student-Opinion Data with Regression and Decision Tree. *Research in Higher Education*, 251-269.

WFD (2000): The Water Framework Directive - integrated river basin management for Europe. Directive 2000/60/EC of the European Parliament and of the Council establishing a framework for the Community action in the field of water policy, adopted on 23 October 2000. http://ec.europa.eu/environment/water/water-framework/index_en.html

Wiers-Jenssen J., Stensaker B., Grogard J.B. (2002): Student satisfaction: towards an empirical deconstruction of the concept. *Quality in Higher Education*, Vol. 8 No. 2: 183-95